

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr. 86 datë 18.9.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9367, DATË 7.4.2005 “PËR
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10, pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1. Çdo institucion, i cili vihet në dijeni me të dhëna personale të çdo zyrtari, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit, nëse diçka e tillë nuk është parashikuar ndryshe në ligj.
2/2. Përmbajtja e autorizimit bëhet në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.”.

Neni 2

Në nenin 19 pika 1, fjalët “sipas seksioneve 1 e 2 të këtij kreu” zëvendësohen me fjalët “sipas seksionit 1 të këtij kreu”.

Neni 3

Në nenin 21, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III seksioni 2 të këtij ligji, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.”.

Neni 4

Në nenin 23 pika 1, fjalët “kur kjo mund të shkaktojë lindjen e konfliktit të interesit të çdo lloji” hiqen.

Neni 5

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Kufizimet për kryetarin e bashkisë, të komunës dhe të këshillit të qarkut

Kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut:

a) nuk mund të jenë drejtues të organizatave fitimprurëse;

b) nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, që ushtron veprimtarinë brenda territorit të juridiksionit të tyre;

c) nuk mund të ushtrorjnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administrator i falimentit, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën “b” të këtij neni, dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

ç) nuk mund të zotërojnë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare që ushtron veprimtarinë brenda territorit të juridiksionit të tyre.”.

Neni 6

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin e parë, fjala “drejtpërdrejt” hiqet.
2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) përcaktimi i kategorisë së zyrtarëve të administratës tatimore e doganore, që u nënshtrohen kufizimeve të parashikuara në këtë nen, bëhet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.”.

Neni 7

Në nenin 37 bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, në fund të shkronjës “b” shtohen fjalët:
“ose, në rastin e organit kolegjal, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt.”.
2. Në fund të pikës 9 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Zyrtari, eprori ose institucioni epror njoftojnë, në çdo rast, Inspektoratin e Lartë për masat e marra për trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave.”.

Neni 8

Në nenin 40, pikat 6 dhe 7 shfuqizohen.

Neni 9

Pas nenit 40 shtohet neni 40/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 40/1

Rregullimi i pasojave juridike të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesave

1. Inspektorati i Lartë ndërmerr nismën e ankimit në rrugë administrative për shpalljen e pavlefshmërisë së akteve a kontratave administrative dhe/ose revokimit/shfuqizimit të tyre nga organet kompetente në çdo rast kur, mbi bazën e verifikimit dhe hetimit administrativ, konstaton konflikt të interesave në zbatim të këtij ligji.
2. Kur një akt i një institucioni publik bëhet i pavlefshëm, sipas përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 e 4 të nenit 40 të këtij ligji:
 - a) institucioni publik, kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim, brenda 30 ditëve nga njoftimi:
 - i) ndërmerr procedurat e dënimit disiplinor ndaj zyrtarit, shkaktar i pavlefshmërisë së aktit;
 - ii) përdor të gjitha mjetet ligjore për kalimin e barrës së dëmshpërblimit të ky zyrtar;
 - iii) i kërkon gjykatës përkatëse edhe vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;
 - iv) bën kallëzim penal ndaj zyrtarit, nëse gjykon se shkelja e kryer nga ai përbën vepër penale;
 - b) përcaktimet e shkronjës “a” të kësaj pike mund të zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari tjetër përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e veta nuk ka parandaluar konfliktin e interesit, shkak për pavlefshmërinë e aktit, ose për moszbatimin e detyrimeve, sipas shkronjës “a” të kësaj pike;
 - c) përcaktimet e shkronjës “a” të kësaj pike zbatohen për zyrtarin në konflikt interesi, shkak të pavlefshmërisë së aktit, sipas rasteve të mëposhtme:

- i) në rastin e deputetit, për votën e dhënë si deputet, zbatohet vetëm shkronja “a” nënndarja “i” e kësaj shkronje;
 - ii) në rastin e gjyqtarit, për vendimet gjyqësore të marra prej tij ose për votën e tij në një vendim gjyqësor, nuk zbatohet shkronja “a” nënndarjet “ii” e “iii” të kësaj shkronje;
 - iii) në rastin e prokurorit, në ushtrim të detyrës, nuk zbatohet shkronja “a” nënndarjet “ii” e “iii” të kësaj shkronje;
 - ç) për zyrtarët e tjerë, që ushtrojnë funksione kontrolli ose hetimi, përcaktimet e shkronjës “a” nënndarjet “ii” e “iii” të kësaj shkronje nuk janë të detyrueshme, por vlerësimi i tyre i mbetet eprorit dhe, në mungesë apo mosveprim të tij, institucionit epror;
 - d) veprimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kryhen nga institucioni publik, sipas rastit, edhe kundër personit të lidhur, personit të besuar ose çdo personi tjetër bashkëpërgjegjës.
3. Në rastin kur vetë institucioni publik nuk e merr këtë nismë, sipas shkronjës “a” të pikës 2, institucioni epror, duke filluar nga ai më i afërti e me radhë, sipas kompetencave ligjore, zbaton detyrat e përcaktuara në të. Në mungesë të veprimit të tyre, detyrat e përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 2 zbatohen nga Inspektorati i Lartë, i cili, sipas rastit, bashkëpunon me Avokaturën e Shtetit.
4. Kundër vendimeve të Inspektoratit të Lartë për konstatimin e konfliktit të interesave në aktet dhe kontratat administrative mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 10

Në nenin 41 pika 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Inspektorati i Lartë vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij.”.

Neni 11

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:
“ë) përcaktimin e modelit të deklarimit të interesave privatë dhe të autorizimit të deklarimit të vazhdueshëm dhe rast për rast të interesave, si dhe të regjistrimit të të dhënave që lidhen me një konflikt të tillë.”.
2. Në pikën 1, pas shkronjës “h” shtohet shkronja “h/1” me këtë përmbajtje:
“h/1) nisjen e veprimeve ligjore në institucionet publike kompetente, me qëllim shpalljen e pavlefshmërisë dhe rregullimin e pasojave që rrjedhin prej saj për aktet dhe kontratat administrative të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesave, me kërkesën e palëve të interesuara ose me nismën e tij.”.
3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:
“1/1. Për verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit rast për rast dhe të vazhdueshëm të interesit, Inspektorati i Lartë ka të drejtë të shfrytëzojë të dhënat e nevojshme në të gjithë aparatit shtetëror e publik dhe në personat juridikë publikë e privatë, të cilët detyrohen të vënë në dispozicion të dhënat e kërkuara nga Inspektori i Përgjithshëm, jo më vonë se 15 ditë.”.
4. Në fund të pikës 3 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:
“Mbi bazën e raportit vjetor, Inspektori i Përgjithshëm harton vlerësime dhe rekomandime lidhur me zbatimin e këtij ligji nga autoritetet përgjegjëse dhe institucionet publike.
Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të autoriteteve përgjegjëse, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm.”.

Neni 12

Në nenin 44 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:
“1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë:
a) për mosvetëdeklarim apo për mosdeklarim me kërkesë, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 7 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

b) për moslëshim autorizimi, sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

c) për shkelje të neneve 21 pikat 1, 2, 3 e 6, 22, 23 pika 1 dhe 24 pika 3 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të, personi i besuar ose drejtuesi i shoqërisë dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

ç) për shkelje të pikave 1 dhe 4 shkronjat "a", "c" dhe "e" të nenit 37, dhe pikave 1, 2, 3, 5 e 8 të nenit 38 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;

d) kur paraqitet gjendja e përcaktuar në shkronjat "a" e "b" të pikës 2 të nenit 40/1, zyrtari dënohet me gjobë nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

dh) kur nuk jepen të dhënat e kërkuara nga Inspektorati i Lartë, sipas pikës 1/1 të nenit 42 të këtij ligji, personat përgjegjës të institucioneve publike dhe private dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

e) në rastet e shkeljeve të mësipërme, gjoba jepet nga Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e eprorit ose të institucionit epror ose, kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt, nga Inspektorati i Lartë;

ë) për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër nga Inspektori i Përgjithshëm, e me propozimin e eprorit të strukturës së institucionit, sipas shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, të institucionit epror, ose kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Lartë, personat përgjegjës dënohen me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

f) për çdo masë administrative, Inspektori i Përgjithshëm njofton eprorin ose institucionin epror të zyrtarit të dënuar."

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të Inspektoratit të Lartë bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes."

Neni 13

Pas nenit 44 shtohet neni 44/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 44/1

Ekzekutimi i gjobave

Të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat e tjera të mbledhura në zbatim të dispozitave të këtij ligji kalojnë të gjitha në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjobës. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi, kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune, ose nga zyra e përbarimit, me kërkesën e Inspektorit të Përgjithshëm."

Neni 14

Në nenin 45 pika 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Për masat disiplinore të marra nga institucionet përkatëse njoftohet rast pas rasti Inspektorati i Lartë."

Neni 15

Në nenin 46 pika 1, shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:

"ç) procesin e identifikimit, regjistrimit, kontrollit dhe hetimit administrativ të interesave privatë të zyrtarëve, të lidhur me konfliktin, rast pas rasti, të interesit, sipas kreut II seksioni 1 të këtij ligji."

Neni 16

Nenet 14, 15, 16, 17 dhe 18 të seksionit 2 të kreut II të këtij ligji shfuqizohen.

Neni 17

Emërtimi “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive” kudo në këtë ligj zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.9.2012

Shpallur me dekretin nr.7777, datë 9.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani